



**AKT - THEMELUES**  
**I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "FEK- 06" sh.p.k.**

Une **Flamur Nuhaj** i biri i Shefitit, i dtl. 27. 12. 1968, lindur ne Usoj dhe banues ne Ballsh, krijoj shoqerine tregtare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "**FEK -06**" dhe me aktin e themelues si vijon:

**FORMIMI**

**NENI 1**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "**FEK- 06**" sh.p.k.. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget, qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise, qe do te miratohet nga ortaku themelues.

**VEND-QENDRIMI I SHOQERISE**

**NENI 2**

Vend-qendrimi i shoqerise tregtare private "**FEK-06**" sh. p.k. do te jete ne lagjen "**5 Shkurti**" Ballsh. Shoqeria do te hap dhe vend-qendrimet e tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente dhe jashte vendit.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**NENI 3**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e :  
Tregetim mallrash te ndryshme ushqimore, mishi e industriale, produkte bujqesore e blegtorale, bime medicinale, elektrike, elektromekanike, elektromjekesore, elektroshtepiake, hidrosanitare, makina e makineri, pjese kembimi, agregate, materiale ndertimi, materiale inerte, me shumice e pakise, eksport - import, sherbime servis makinash, lavazho e parkim, trasporte te ndryshme rrugore mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte vendit, sherbim taksi te cdo niveli, punime ne sektorin pyjor, grumbullimin e prodhimeve te dyta pyjore.



Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, perpunimi, sherbimi e tregetimi dhe do te bashkepusoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

##### **NENI 5**

Koehezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfardo lloj shkaku

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

##### **NENI 6**

Kapitali i shoqerise tregtare private "FEK- 06" sh. p.k. do te jete 100.000 leke dhe do te perbehet nga kuota e ortakut te shoqerise.

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut themelues. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe nenshkrueshem.

##### **NENI 7**

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demetoje interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

#### **DREJTIMI I SHOQERISE**

##### **NENI 8**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj **z. FLAMUR NUHAJ.**

##### **NENI 9**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut themelues te shoqerise.

##### **NENI 10**

Ortaku themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise.

Ai ka te drejte te caktojte financier, likujdator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtojte persona te tjere si ortake.



Financieri nxjerre rregullisht treguesit financiar te tre-mujoreve, 6-mujoreve dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

#### **NENI 11**

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

#### **NENI 12**

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme, me tekstin per rrethin e saj .

#### **NENI 13**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plot te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr. 7638 date 19. 11. 1992 " Mbi krijimin e shoqerive tregetare".

#### **NENI 14**

Ky akt themelimi do te hyrje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente.

#### **NENI 15**

Akti i themelimit u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private "FEK-06" sh. p. k. Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE  
"FEK -06" sh. p. k.  
FLAMUR NUHAJ**

*Flamur Nuhaaj*



**S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FEK- 06"**

Ne baze te ligjit 7512 date 10. 08. 1991 " Per sanksionimin dhe mbrojten e prones private, nismes se lire te veprimtarive private dhe privatizimit" dhe te ligjit Nr. 7638 date 19. 11. 1992 " Per shoqerite tregtare " , me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenskrimin e Aktit Themelues:

Une **Flamur Nuhaj** i biri i Shefitit, dtl. 27. 12. 1968, lindur ne Usoj dhe banues ne Ballsh te rrethit Mallakaster.

Hartoj statutin e shoqerise si me poshte:

**EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

Shoqeria emertohet "**FEK-06**" sh. p. k.

**NENI 2**

Selia e shoqerise tregtare private "**FEK-06**" sh. p. k. do te jete ne lagjen "5 Shkurti" Ballsh.

**NENI 3**

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

**NENI 4**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e :

Tregetim mallrash te ndryshme ushqimore, mishi e industriale, produkte bujqesore e blegtorale, bime medicinale, elektrike, elektromekanike, elektromjekesore, elektroshtepiake, hidrosanitare, makina e makineri, pjese kembimi, agregate, materiale ndertimi, materiale inerte, me shumice e pakise, eksport - import, sherbime servis makinash, lavazho e parkim, transporte te ndryshme rrugore mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte vendit, sherbim taksi te cdo niveli, punime ne sektorin pyjor, grumbullimin e prodhimeve te dyta pyjore.

## KAPITALI I SHOQERISE

### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregetare private "FEK- 06" sh. p. k. do te jete 100.000 lek. Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

### NENI 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te palujteshme etj. te nevojshme per ushrimin e aktivitetit te shoqerise.

### NENI 7

Kuota e kapitalit fillestar eshte derdhur nga ortaku themelues ne Banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si dhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

### NENI 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, i takojne ortakut themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

### NENI 9

Shoqeria tregetare "FEK- 06" sh. p. k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vete tek te tjeret.

Ne Republikën e Shqipërisë, Shoqëria tregëtare "FEK- 06" sh. p. k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.





**NENI 10**

Shoqeria tregëtare "FEK-06" vepron në rregjistrimin e pronës private dhe merre përsipër të drejtat dhe detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku themelues i shoqërisë mbarë rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë. Vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 11**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj z. **FLAMUR NUHAJ**.

**NENI 12**

Hyjnë brenda detyrave dhe kompetencave të ortakut themelues si më poshtë:

1. Ndryshimi i aktit të themelimit dhe i statutit të shoqërisë.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve të administrimit, i inventareve dhe bilancit e llogarive vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kompetencave të tyre, me përjashtim të atyre që shënohen në statut.
4. Aprovimi i garancive që ka shoqëria.
5. Miratimi i tarifave për shërbimet që kryen nga shoqëria.
6. Pranimit në punë dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formës së vules dalluese të shoqërisë.

Kryerja e të gjitha veprimeve të administrimit të Shoqërisë në emër, për llogari dhe për interes të saj.

**NENI 13**

Administratori jo ortak përveç detyrave që i caktojnë ortakët e shoqërisë ka edhe këto detyra të tjera:

1. Të mirë-administrojë pasurinë e shoqërisë.
2. Të bëjë marrëveshje me të tretet brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakut themelues.
3. Të zbatojë rregulloren e brendshme të shoqërisë
4. Të përgjigjet për dëmet që i sjellë Shoqërisë nga veprimet e tij.
5. Të paguhet për punën që kryen në bazë të marrëveshjes së bërë me ortakun themelues.





6. Te marre te dhena dhe te beje propozime pergjitheçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.

7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

## **TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE**

### **NENI 14**

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise.

2. Te siguroje pasurine e vete.

3. Te marre kredi ne leke dhe ne valite nga Bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.

4. Te perfitoje nga favoret qe i njehe legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.

5. Te investoje kudo ne Shqiperi nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.

6. Te punesoje puntore te thjeshte, ose te kualifikuar vendas ose te huaj.

7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

### **NENI 15**

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.

2. Te siguroje punonjesit e saj.

3. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si dhe detyrimet kontraktuale ndaj cililto. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

## **MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE**

### **NENI 16**

E gjithe veprimtarise e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.





**NENI 17**

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentaconi financiar ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

**NENI 18**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

**NENI 19**

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatsë.

**NENI 20**

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi bene zbritjen e humbjeve te vitit te mepareshem, le menjane 5% te fitimit me te cilin krijohet fondi.

"Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije masen 10% te kapitalit themeltar.

**NENI 21**

Te ardhurat neto pas veçimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdorim ortakut themelues te shoqerise.

Konvertimi i parase i realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit Shqiptar, ose bankat e tjera private dhe trasferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikës së Shqipërisë.

**DISPOZITA TE VEÇANTA**

**NENI 22**

Shoqeria ka vulen e vet dalluese

**SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

**NENI 23**

Shnderrimi i shoqerise "FEK-06" sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut themelues.





**NENI 24**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise.
- Pamundesi veprimi.
- Me vendim te asamblese se ortakeve.

Ne keto raste, pronari i shoqerise vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume liujdatore, duke ju percaktuar detyrat.

Administratori dhe likujdatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise perderi sa ajo tu dorezohet personave perkates fizike apo juridike, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel rezultojne te pamjaftueshme per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, lukuidatori mund te kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe i takojne atij.

**DISPOZITA TE PERGJITHESHME**

**NENI 25**

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaku themelues, si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.

**NENI 26**

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private "FEK- 06" sh.p.k..

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**"FEK- 06" sh. p. k.**

**FLAMUR NUHAJ**

*Flamur Nuhaaj*